

V E N D I M
Nr.10 date 7.1.2010

PER MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullores "Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR LICENCIMIN DHE INSPEKTIMIN E VEPRIMTARIVE ME BURIME TE
RREZATIMEVE JONIZUESE

1. Objekti i rregullores

Në zbatim të Ligjit Nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, kjo rregullore përcakton:

- a) procedurat e licencimit të personave fizikë dhe juridikë, që është subjekt i ligjit sipas nenit 3 të Ligjit Nr 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar
- b) kriteret e posaçme që duhet të plotësojnë këto subjekte
- c) afatet e shqyrtimit apo vendimmarrjes së licencës;
- d) procedurat e revokimit;
- e) mënyrën e inspektimit dhe kontrollit të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore , që lidhen me rrezatimin nga ana e subjekteve të licencuara.

2. Përjashtimet

Përjashtohen ose nuk përfshihen fare nga detyrimet e kësaj rregulloreje praktikat dhe burimet siç përcaktohen në listën e miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi (KMR).

3. Licensimi

- Çdo person juridik ose fizik që ushtron veprimtaritë e përcaktuara në nenin 3 të ligjit 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar është i detyruar të pajiset me licencë nga KMR.
- Kriteret bazë mbi të cilat mbështetet aplikimi për licencë janë sigurimi, siguria dhe mbrojtja nga rrezatimet sipas formularëve bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtaritë e mësipërme, subjekti duhet të përmbushë kriteret e posaçme, si më poshtë.
- Përshtatshmëria e njohurive dhe e eksperiencës së personelit në mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin.
- Përshtatshmëria fiziko-shëndetësore e personelit.
- Siguria dhe sigurimi nga rrezatimi jonizues.
- Justifikimi, optimizimi dhe kufizimi i dozave.
- Siguria e origjinës, transportit, përdorimit dhe trajtimit të burimit në fund të jetës dhe ose veprimtarisë.
- Përshtatshmëria e paisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standartet e shërbimit.
- Përshtatshmëria e rregullave për punë të sigurt për veprimtari normale, si dhe në raste emergjencash.
- Për marrjen e licencës subjekti duhet të drejtohet KMR-së për aplikim jo më vonë se 90 dite pune përpara parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Kërkesa bëhet nëpërmjet aplikimit për licencë në ZMR.
- Nëpërmjet inspektorëve të saj, KMR-ja bën shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur, kërkon dokumente shtesë kur është e nevojshme dhe njëkohësisht bëhet verifikimi në vend dhe lëshohet një dokument vlerësimi nga ana e inspektorëve të zyrës për mbrojtjen nga rrezatimi, i cili merr në konsideratë mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin.
- Pas vlerësimit nga ZMR-ja, dërgohet në KMR për miratim. Ekspertiza në lidhje me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin realizohet nga përdoruesit, persona fizikë e juridikë me mbështetjen e ekspertëve në këto fusha (të njohur nga ana e KMR-se), por gjithmonë mbetet përgjegjësi e plotë e aplikantit mbrojtja nga rrezatimet, siguria dhe sigurimi.
- Në rastin e ndërtimit me faza të një praktike, e cila përfshin aktivitetet e përshkruara në nenin 3 të ligjit, bëhet miratimi paraprak për plotësimin e mëtejshëm të aplikimit.
- Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të aplikimit jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit dhe njofton me shkrim përdoruesin.
- Për çdo përdorues mbahet një dosje, e cila në rastin e rinovimit plotësohet me elementet shtesë dhe kërkesat e KMR-së. Ngarkohet ZMR-ja për plotësimin dhe mirembajtjen e arkivit të dosjeve tij.
- ZMR-ja, pas miratimit të licencës nga KMR-ja, përgatit licencën për subjektin përkatës sipas formatit të miratuar nga KMR-ja.
- Procedurat e vlerësimit të aplikimit për licencë miratohen me vendim të KMR-se.

4. Afati i vlefshmerise se licences.

Licenca jepet për një periudhë 5 vjecare. Pas kalimit të këtij afati ajo bëhet e pavlefshme. Të paktën dy muaj përpara mbarimit të afatit të licensës përdoruesi është i detyruar të njoftojë me shkrim KMR –ne për pushimin ose mbylljen e aktivitetit. Në cdo, rast përdoruesi është i detyruar të zbatojë procedurat për mbylljen e aktivitetit duke marrë të gjitha masat për likuidimin e ndonjë kontaminimi të mundshëm radioaktiv ose masa të tjera që sigurojnë ambjentin dhe publikun.

Nëse mbajtësi i saj kërkon rinovimin e licensës, KMR-ja vepron sipas procedurës së përshkruar në piken 3 të kësaj rregulloreje . Personat fizike ose juridike duhet të njoftojnë ZMR-ne për cdo ndryshim, modifikim eventuale veprimtarisë që ata kryejnë ose burimeve siç është parashikur në licence për një afat dy muaj përpara ndryshimit . Shtesat e burimeve radioaktive në licence brenda kategorisë behen vetëm me ndryshimin e shtojcës për burimet duke njoftuar dhe me miratimin nga ZMR-ja.

Në rastin kur Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet arrin në përfundimin se si rezultat i ushtrimit të një veprimtarie që përmbahet në nenin 3 të ligjit krijohet rrezik për shëndetin e punonjësve, të popullatës ose për dëmtimin e mjedisit, i refuzon dhënien e licensës personit fizik ose juridik që e kërkon atë ose kur veprimtaria është e licencuar, i heq atij licensën .

5. Inspektimi

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet nëpërmjet inspektoreve kontrollon zbatimin e dispozitave që lidhen me mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin e të gjitha veprimtarive të licencuara. Inspektorët pajisen me fletënjoyhje lëshuar nga ky Komision. Statusin e inspektorit të mbrojtjes nga rrezatimet e përfitojnë për shkak të detyrës punonjësit e zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet .

6. Detyrat e inspektorëve

Inspektorët e ZMR kanë për detyrë :

1. Të inspektojnë dhe kontrollojnë cdo pajisje me lëndë radioaktive ose pajisje tjetër rrezatuese (aparate Rontgeni etj.) dhe cdo objekt që dyshohet se ka lëndë radioaktive ose është pajisje rrezatuese, si dhe të kryejnë ekzaminime të tjera bazë për t'u siguruar që masat mbrojtëse nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin janë zbatuar plotësisht.

2. Të kërkojnë nga personat që ushtrojnë veprimtari të licencuar sipas nenit 3 të ligjit , dokumente dhe regjistra që lidhen me veprimtarinë e ushtruar, si dhe të kërkojnë informacione lidhur me përmbajtjen e këtyre dokumenteve.

3. Kanë të drejtë të pyesin dhe të kërkojnë shpjegime mbi ushtrimin e praktikës dhe përdorimin e burimeve. Inspektorët kanë të drejtë të marrin kopje ose ekstrakte nga këto dokumente. Inspektorët duhet të ruajnë konfidencialitetin e materialeve dhe biznesit. Materialet depozitohen në dosjen përkatëse në ZMR.

7. Veprimet e inspektoreve kur i licensuari paraqet rrezikshmeri.

Në rastin kur inspektorët , në bazë të rezultateve të kontrollit, arrijnë në përfundimin se një veprimtari ndonëse e licencuar paraqet rrezik për punonjësit, publikun ose për mjedisin, ata kanë të drejtë të kryejnë këto veprime:

- a) Të vendosin nën kontroll dhe ruajtje të gjitha pajisjet që përfshihen në veprimtarinë që paraqet rrezik.
- b) Të pezullojnë përkohësisht punën e të gjitha pajisjeve dhe aparaturave.

- c) Të urdhërojnë marrjen e masave të nevojshme për pastrimin e ndotjeve radioaktive nga pajisjet, vendet e punës ose nga objektet e tjera të ndotura dhe cdo lloj mase tjetër që lidhet me sigurinë dhe sigurimin.

8. Të drejtat e inspektorëve

Gjatë ushtrimit të detyrave që parashikohen në pikat 6 dhe 7, inspektorë kanë të drejtë:

- a) Të hyjnë në cdo kohë të përshtatshme në vendet ku kryhen veprimtari të parashikuara në nenin 3 të ligjit 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar ose në vende që dyshohen se kryejnë veprimtari të tilla.
- b) Të urdhërojnë personat juridike e fizike që të mos kryejnë veprime që do të krijonin ose rëndonin një situatë emergjencë radiologjike.

KMR-ja percakton menyren e pergatitjes se raportit te inspektimit.

Në rastin kur një person juridik ose fizik pengon kryerjen e detyrave të një inspektori ose kundërshton veprimet e tij sipas pikave 6, 7 dhe 8 ai quhet fajtor dhe ndëshkohet me gjobë për kundravajtje administrative sipas ligjit nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar. Te drejten e vendosjes se gjobave e kane inspektorët e zyrës se mbrojtjes nga rrezatimet.

9. Ndreqja e te metave nga subjekti i licencuar

Për të gjitha konstatimet e inspektoreve gjatë ushtrimit të kontroleve, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ushtron kompetencat mbi personat që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në rregullore për ndreqjen e të gjitha të metave të konstatuara deri në një afat të caktuar nga inspektori dhe verifikohen nepërmjet një inspektimi të ri. Moskorrigjimi i të metave nga ana e personave çon në pezullimin e licencës e deri në heqjen e saj.

10. Ankimimi i vendimeve

Kundër vendimit të inspektorit ,subjekti i licencuar ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet brenda 15 diteve.

Kundër vendimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, subjekti i licencuar ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja njoftim e vendimit.

APLIKIMI PËR LICENSË PËR VEPRIMTARI ME BURIME TE MBYLLURA RADIOAKTIVE

KËRKESE PËR LICENCË

PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE

Burime të mbyllura dhe të hapura radioaktive

Aplikim i ri _____

Amendim i Licences _____

Rinovim i licenses _____

1. Personi juridik/ fizik : Institucioni _____
Emri Mbiemri _____

Adresa _____
Adresa e Kabinetit n.q.s është e ndyshme nga më sipër

Tel _____
Fax _____
Email _____

Bashkangjitur paraqit një kopje të regjistrimit të personit juridik / fizik.QKR

2. Përshkruani ambientet ku kryhet veprimtaria me rrezatime jonizuese .

Paraqisni veças planimetrinë e ambjenteve, vendodhjes së burimit , pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme ,dyerve ,dritareve , ventilatorëve , pasazheve , dhomës së errët , ambjenteve të pritjes , qëndrimin e personelit , ambjentet rreth kabinetit , materialin dhe trashësinë e mureve dhe madhësitë përkatëse , dimensionet .Paraqit planin e sigurisë fizike sipas grupit të sigurisë . Te dokumentohet destinacioni i ambjenteve.

Importimi , përfitimi i burimit .

3. Lloji i Burimit radioaktiv :

Prodhuesi _____
Emri i prodhuesit _____
Adresa e prodhuesit _____
Radionuklidi _____
Modeli _____
Aktiviteti fillestar _____
Energjitë _____
Forma kimike dhe fizike _____
Seria _____

Bashkangjit fletë shtesë në të njëjtën strukturë si më sipër në rast se janë më shumë se një burim .

4. Qëllimi i përdorimit të burimit radioaktiv _____

5. Përcakto kush do të jetë shërbimi i autorizuar, i cili do të kryejë shërbimet e pajisjeve që përdorin burimin.

6. Jep një performacë të dozave në ambientet publike, në ato të kontrolluara dhe të survejuara. Jep një informacion mbi justifikimin , optimizimin dhe kufizimin në dozat limit për aktivitetin .

7. Struktura organizative

Paraqit bashkëngjitur dokumente mbi strukturën organizative . Paraqit dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Strategjia e kontrollit fizik dhe mbrojtjes nga rrezatimet .Jep listën e punonjësve që do të manipulojnë me burimin dhe gjithashtu kualifikimet e tyre dhe personave që kane akses në zonat e kontrolluara .

8. Për monitorimin dhe kontrollin e dozës së ekspozimit gjatë punës me rrezatimet jonizuese kërkohet realizimi i një kontrate me Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar,Tiranë.

Paraqesni një kopje të kontratës

9. Të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit

Emri _____

Mbiemri _____

Profesioni _____

Kualifikimi në fushën e radiombrojtjes

Paraqit një kopje të kontratës së punës

10. Përshkruani masat e sigurisë dhe procedurat e trajtimit të aksidenteve të mundshme lidhur me pajisjet që keni në përdorim.

11. Të paraqiten dokumente ,nëpërmjet të cilave vërtetohet që burimi i konsumuar do të trajtohet në qendrat përkatëse të mbetjeve në fund të përdorimit .

12.Dokumentacioni.

Mënyra e ruajtjes së dokumentacionit për dozimetrike personale , izodozave , incidenteve , trajnimit , shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punonjësve .

13. Të bëhet një vlerësim me shkrim nga ana e përdoruesit nepermjet eksperteve për mbrojtjen nga rrezatimi siguline dhe sigurimin .

14. Paraqisni një dokument mbi kontrollin mjekësor periodik të punonjësve që punojnë me burime të rrezatimit jonizues .

Për sa më sipër kërkoj dhënien e licensës për _____ duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme

Data _____

Nënshkrimi _____

I gjithë dokumentacioni të jetë në origjinal , i noterizuar ose me vulë lidhëse të institucionit tuaj .

Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari, dërgojeni atë së bashku me dokumentat e tjera të nevojshme , në adresën e mëposhtme :

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
Instituti i Shëndetit Publik
Aleksander Moisiu 80
Tiranë

Dërgimi i një kërkesë të paplotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë do të sjellë vonesa , për të cilat përgjegjësia bie mbi kërkuarës të licensës. Bazuar në nenin 3 të rregullores për licencim dhe inspektim për marrjen e licensës ,çdo person juridik dhe fizik i drejtohet me një kërkesë ZMR-së. Mbas kërkesës, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për lëshimin ose moslëshimin e licensës, jo më vonë se 90 dite pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

Shënim :

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr.8025 date 9 . 11. 1995, të ndryshuar , si dhe të rregullores , kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standarteve baze të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese ,përzullimin ose mbylljen e tyre.
3. Tërheqja e burimeve të rrezatimeve jonizuese nga pikat doganore, në bazë të njoftimit të bërë në ZMR (formulari) bëhet në bazë të një lejeje që jepet nga ZMR-ja ose KMR-ja.

INSPEKTIMI PËR DHËNIEN E LICENCËS

1. Lloji i burimeve të rrezatimeve jonizuese :
 2. Dokumentacioni .Të shënohen kutitë e mëposhtme mbi bazën e materialeve bashkangjitur dhe të firmoset nga inspektori
- Aplikimi
 - Kopje e regjistrimit në QKL

- Importi
- Servisi
- Planimetria
- Dokumentacion për pajisjen nr i faqeve
- Kontratë për Dozimetrinë Personale
- Kualifikimet e personelit
- Plani i Emergjencave
- Performanca e dozave
- Vlerësimi i sigurise dhe sigurimit .
- Kontrolli mjekësor

Data _____ Inspektori: Emri, Mbiemri, Firma _____

LICENCIMI

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pasi analizoi kërkesën, aprovoi dhënien e licencës për një afat _____ vjeçar.

Data _____ Kryetari i ZMR

APLIKIMI PËR LICENCË PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X

KËRKESË PËR LICENCË

PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMEVE JONIZUESE
Gjeneratorë me rreze x.

Aplikim i ri _____
Amendim i licencës _____
Rinovim i licencës _____

1. Personi juridik/ fizik : Institucioni _____
Emri Mbiemri _____
Adresa _____
Adresa e Kabinetit n.q.s është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
Fax _____
E-mail _____

Bashkëngjitur një kopje të regjistrimit të personit juridik / fizik.QKR

2. Përshkruani ambientet ku kryhet veprimtaria me rrezatime x .

Paraqisni veças planimetrinë e ambjenteve, vendndodhjes së panelit të kontrollit , pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, dhomës së errët, ambjenteve të pritjes së pacientëve, qëndrimin e personelit, ambjentet rreth kabinetit, materialin dhe trashësinë e mureve dhe madhësitë përkatëse, dimensionet.Zonat e kontrolluara dhe të survejuara .Të dokumentohet destinacioni i ambjenteve

Importimi, përfitimi i pajisjes .

3. Lloji i Gjeneratorit me rreze x :

Prodhuesi _____
Emri _____
Adresa _____
Tensioni maksimal _____
Rryma maksimale _____
Koha javore e ekspozimit _____
Ngarkesa javore (numri) _____
Numri i tubave _____
Model _____
Seria _____

Bashkëngjit fletë shtesë në të njëjtën strukturë si më sipër në rast se janë më shumë se një pajisje.

4. Qëllimi i përdorimit të gjeneratorëve me rreze x _____

5. Përcakto kush do të jetë shërbimi i autorizuar, i cili do të kryejë shërbimet e pajisjeve

6. Jep një performacë të dozave në ambjentet publike ,në ato të kontrolluara dhe të survejuara.
Jep nje informacion mbi justifikimin , optimizimin dhe kufizimin në dozat limit për aktivitetin. _____

7. Struktura organizative

Paraqit bashkëngjitur dokumente mbi strukturën organizative. Paraqit dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Strategjinë e mbrojtjes nga rrezatimet. Jep listën e punonjësve që do të manipulojë me pajisjen dhe gjithashtu kualifikimet e tyre dhe personave që kanë akses në zonat e kontrolluara .

8. Për monitorimin dhe kontrollin e dozës së ekspozimit gjatë punës me rrezatimet jonizuese kërkohet realizimi i një kontrate me Qendren e Fizikes Berthamore te Zbatuar,Tiranë.

Paraqisni një kopje të kontratës.

9. Të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit

Emri _____

Mbiemri _____

Profesioni _____

Kualifikimi në fushën e radiombrojtjes _____

Paraqit një kopje të kontratës së punës.

10. Përshkruani masat e sigurisë dhe procedurat e trajtimit të aksidenteve të mundëshme lidhur me pajisjet që keni në përdorim.

11. Regullat e brendshme dhe supervizimi

Të paraqitet një informacion mbi funksionimin e brendshëm të Qendrës , kabinetit në formë kodi ose në çdo formë tjetër .

12.Dokumentacioni.

Mënyra e ruajtjes së dokumentacionit për dozimetrike personale , izodozave , incidenteve , trajnimit , shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punonjësve .

13. Të bëhet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi .

14. Paraqisni një dokument mbi kontrollin mjekësor periodik të punonjësve që punojnë me gjeneratorë me rreze x.

Për sa më sipër, kërkoj dhënien e licencës për _____ duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

Data _____

Nënshkrimi _____

I gjithë dokumentacioni të jetë në origjinal , i noterizuar ose me vulë lidhëse të institucionit tuaj .

Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari, dërgojeni atë, së bashku me dokumentat e tjera të nevojshme, në adresën e mëposhtme :

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
Instituti i Shëndetit Publik
Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr. 80
Tiranë

Dërgimi i një kërkesë të paplotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë do të sjellë vonesa, për të cilat përgjegjësia bie mbi kërkuuesin e licencës. Bazuar në nenin 3 të rregullores për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik i drejtohet me një kërkesë ZMR-se. Mbas kërkesës, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për lëshimin ose moslëshimin e licencës ,jo më vonë se 90 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

Shënim :

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995 i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standarteve baze të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.
3. Tërheqja e burimeve të rrezatimeve jonizuese nga pikat doganore, në bazë të njoftimit të bërë ZMR (formulari), bëhet në bazë të një lejeje që jepet nga ZMR-ja ose KMR-ja.

INSPEKTIMI PËR DHËNIEN E LICENCËS

1. Lloji i burimeve të rrezatimeve jonizuese :
 2. Dokumentacioni - Të shënohen kutitë e mëposhtme mbi bazën e materialeve bashkëngjitur dhe të firmoset nga inspektori.
- Aplikimi
 - Kopje e regjistrimit në QKL
 - Importi
 - Servisi
 - Planimetria
 - Dokumentacion për pajisjen nr i faqeve
 - Kontratë për Dozimetrinë Personale
 - Kualifikimet e personelit
 - Plani i emergjencave
 - Performanca e dozave
 - Vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet
 - Kontrolli mjekësor

Data _____ Inspektori: Emri, Mbiemri, Firma _____

LICENCIMI

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet pasi analizoi kërkesen, aprovoi dhënien e licencës për një afat _____ vjeçar.

Data _____

Kryetari i ZMR